

Tadiçi, Serbia e Madhe dhe çështja shqiptare

Ditët e fundit, autoritetet më të larta të shtetit dhe politikës serbe, si presidenti Boris Tadiç, njëkohësisht lider i Partisë Demokratike Serbe si dhe ministri i brendshëm Ivica Daçiç, lider i Partisë Socialiste Serbe (ish partia e Slobodan Millosheviçit), kanë rihedhur në tregun politik tezën e ndryshimit të kufijve në rajon, duke ia shtuar kështu turbullirën ujërave në Ballkan.¹

Me justifikimin e gjetjes së zgjidhjeve sa më afatgjatë të konflikteve në rajon, politika serbe, duke propozuar me zë ndarjen e Kosovës e duke nënkuptuar nën zë ndarjen edhe të Bosnjës, duket se i janë kthyer synimit për krijimin e asaj çfarë ka mbetur nga projekti i Serbisë së Madhe, këtë herë jo me luftë si Millosheviçi, por me rrugë në dukje paqësore.

Këtë objektiv të riformatuar të serbëve, Tadiçi po përpiqet që ta kamuflojë, duke bërë diversion ndaj zgjidhjes së çështjes shqiptare në Ballkan. Për Tadiçin Serbia e Madhe i bie të bëhet si pasojë e aktualizimit të krijimit të Shqipërisë së Madhe. Sipas Tadiçit, Shqipëria e Madhe është një projekt i rrezikshëm, por mund të jetë pjesë e një zgjidhjeje më të madhe dhe se serbët “mund të jetojnë me këtë (zgjidhje)”.

Qëllimisht Tadiçi përdor “Shqipëri e Madhe” si term analog me termin “Serbi e Madhe”. Ky paralelizëm që bëhet shpesh mes përpjekjeve të shqiptarëve për zgjidhjen e çështjes së tyre në rajon me ato të serbëve për Serbinë e Madhe apo grekëve për Greqinë e Madhe, është qëllimkeq. Këto terma përmbajnë në vetvete një koncept negativ, duke nënkuptuar një shtet të zmadhuar me dhunë, pa të drejtë, domethënë duke pushtuar territoret e të tjerëve.

Historia e ka provuar plotësisht këtë për serbët. “Serbia e Madhe” është produkt i Naçertanie-s (“Projektit”) së Ilia Garashanit, programit të hershëm në vitin 1840, i cili do të vihej në themel të politikës serbe që nga krijimi i shtetit serb e deri në ditët e sotme. Ky program politik synoi të krijonte një shtet të madh, që do të përtërinte perandorinë mesjetare të Stefan Dushanit. Nga zbatimi i këtij programi për gati një shekull, ndonëse nuk arriti kufijtë e Stefan Dushanit, Serbia që nga pavarësia e saj e deri vitin 1912, zgjeroi sipërfaqen në kurriz të fqinjëve të saj, kryesisht të shqiptarëve, me tre herë e gjysëm, duke u shndërruar kështu në një Serbi të Madhe.

Ndërkohë që serbët, në zbatim të Naçertanie-s, synonin zgjerimin me dhunë të kufijve të shtetit serb, përpjekjet për zgjidhjen e çështjes shqiptare në rajon asnjëherë nuk mund të quhen përpjekje për krimin e Shqipërisë së Madhe. Sepse Lëvizja Kombëtare Shqiptare për

¹ Artikulli është botuar në të përditshmen “Koha Jone” 25 Qershor 2011

zgjidhjen e çështjes shqiptare në rajon, duke qenë një lëvizje politike e themeluar në hapësirën gjeopolitike shqiptare, në një periudhë të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar, me objektiv kryesor krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, nuk ka patur asnjëherë si synim projektimin dhe ndërtimin e një shteti shqiptar që të përfshijë në hapësirën e tij territore jo shqiptare.

Kështu që edhe deklarimi i Tadiçit disa ditë më parë për gazetën gjermane “Frankfurter allgemaine Zeitung” se “kush di të interpretojë historinë do të vërejë se formimi i Shqipërisë së Madhe ka qenë një plan afatgjatë politik i shqiptarëve”, është vazhdim i propagandës së qarqeve antishqiptare. Ajo është një shtrembërim me dashje i synimeve të shqiptarëve për zgjidhjen e drejtë të çështjes së tyre në rajon.

Është e vërtetë se shqiptarët asnjëherë nuk i ndërprejnë përpjekjet për zgjidhjen e çështjes kombëtare dhe pa zgjidhjen e saj në vazhdimësi paqja dhe siguria në Ballkan do të mbeteshin të rrezikuara. Por përpjekjet për zgjidhjen sa më të mirë të mundshme të çështjes shqiptare në rajon kurrë nuk mund të quhen përpjekje për krijimin e “Shqipërisë së Madhe”. Shqiptarët vetë nuk e përdorin këtë term. Pra, për ta Shqipëria nuk është as e madhe as e vogël, por ajo që është dhe që duhet të jetë, Shqipëria etnike apo dhe Shqipëria natyrale. Për këtë ne duhet të flasim me zë të lartë dhe të bindim faktorin ndërkombëtar.

Por, pse u deklarua pikërisht tani Tadiçi se “bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë mund të ishte një zgjidhje për konfliktin shumëvjeçar”. Në të vërtetë, ndryshimi i pozicionit serb nga deklarimi i “mosnjohjes kurrë të shtetit të Kosovës” deri tek pranimi i “Bashkimit të Kosovës me Shqipërinë” po të mos ketë prapavijë tjetër, është një zhvillim mjaft interesant në politikën serbe.

Politika serbe tashmë e ka kuptuar se shteti i Kosovës është një realitet që nuk mund të zhbëhet. Ky realitet është i konfirmuar politikisht nga faktorët kryesorë ndërkombëtarë BE, SHBA e tjerë si dhe juridikisht nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Kështu që edhe në këtë rast politika serbe po përpiqet të nxjerrë sa më shumë përfitime, disa prej të cilave janë në dëm të çështjes shqiptare. Kështu, duke kërkuar gjoja bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, krijohet tymnajë rreth të ardhmes së shtetit të Kosovës dhe synohet ngadalësimi i njohjes ndërkombëtare të saj; paraprakisht kërkon ndarjen e Kosovës duke synuar marrjen e pjesës së saj veriore; synon përgatitjen e kushteve për ndarjen e Bosnjës dhe bashkimin me Serbinë të Republikës Serbska; synon të lehtësojë rrugën drejt BE-së të Serbisë duke u paraqitur bashkëpunues për çështjen e Kosovës; synon të mbajë nën presion fqinjët e saj Malin e Zi dhe Maqedoninë, të cilët njohën shtetin e pavarur të Kosovës, etj.

Propozimi i Tadiqit për ndarjen e Kosovës nuk është i ri. Në të vërtetë, që në vitin 2004, rreth një vit përpara fillimit të bisedimeve për statusin përfundimtar të Kosovës, Instituti Amerikan i Paqes, i drejtuar nga Daniel Server, ekspert për çështjet ballkanike, si opsion të fundit, kishte parashikuar pavarësinë me ndarje të Kosovës. Sipas këtij varianti, komunat e veriut Zveçan, Zubin Potok, Leposavic, si dhe Mitrovica e Veriut do të shkonin me Serbinë. Shumica e komunave shqiptare në Serbinë e Jugut do të bëheshin pjesë e Kosovës së Pavarur. Pra, do të kishte një shkëmbim terriroresh.

Zyrtarisht Grupi Kontaktit, SHBA dhe BE, e hodhën poshtë këtë variant. Sepse që përpara fillimit të bisedimeve Grupi i Kontaktit dhe Këshilli Sigurimit të OKB-së miratuan kornizën e bisedimeve, duke vendosur “ndalim kalimi” në ato rrugë që synonin kthimin e Kosovës në gjendjen e para vitit 1999, ndarjen e saj apo dhe ndryshimin e kufijve duke u bashkuar me ndonjë shtet tjetër. Ata nuk do të pranonin ndarjen e Kosovës pasi ishin të bindur se kjo do të përbënte një precedent destabilizues për Bosnjën, Maqedoninë e Serbinë.

Evoluimi nga mendimi i dikurshëm se paqja në Ballkan arrihej duke copëtuar trojet etnike shqiptare deri tek bindja e tanishme se pa zgjidhur çështjen shqiptare nuk mund të ketë paqe e siguri në rajon, është një zhvillim mjaft i rëndësishëm për zgjidhjen përfundimtare të çështjes kombëtare shqiptare, të çështjes shqiptare në rajon dhe për paqen e sigurinë rajonale.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe njohjes së saj ndërkombëtare nga aktorët kryesorë të politikës dhe ekonomisë botërore, zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare dhe çështjes shqiptare në rajon ka hyrë në një fazë të re, drejt asaj përfundimtare. Këtë e ka kuptuar mjaft mirë Tadiqi dhe aleatët e tij dhe ata nuk do të arrijnë që me skenarët e tyre ta frenojnë atë.

Nëse vërtet Tadiqi dhe politikanët serbë kërkojnë të bëhet konstruktive dhe realiste në raport me shqiptarët dhe sigurinë në rajon si dhe me serbët jashtë territorit të shtetit serb, duhet fillimisht të demotivojnë strukturat paralele serbe në veri të Kosovës, të ndërpresin aktivitetin e tyre subversiv ndaj shtetit të Kosovës dhe ta njohin zyrtarisht atë. Vetëm kështu ata do të mund të integrohen plotësisht në BE e NATO. Më pas, në një moment të përshtatshëm, në bashkëpunim me faktorët kryesorë ndërkombëtarë, mund të propozojnë organizimin e një “Dejtoni” tjetër, këtë herë për Ballkanin.

Si përfundim Tadiçi, Daçiçi dhe të tjerë duhet të kujtohen se ka ikur koha kur mund të bëhej tregëti me territoret shqiptare dhe se zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare dhe çështjes shqiptare në rajon, pavarësisht pengesave serbe, ka hyrë në një fazë të re, drejt asaj përfundimtare. Nismat qëllimkeqe serbe ndaj shqiptarëve apo dhe popujve të tjerë në rajon do të dështojnë dhe projekti i Tadiçit për

Serbinë e Madhe në rrugë “paqësore” do të pësojë të njejtin fat si Serbia e Madhe që tentoi të krijojë Millosheviçi me luftë.

me të bledh, duke mbledhur nga
www.raiffeisen.ch

20 Lekë

Koha Jone

E shtunë, 25 Qershor 2011, Nr. 173 (6030) E përditshme e pavarur Nga 11 maj 1991 Çmimi 20 Lekë; Gr

Flet kreu i Partive Popullore Evropiane: Ka një gjykatë për rezultatin e zgjedhjeve. Vo

PPE: Tirana, PS të vendimin e Kolegjit

Eurodeputetët deklaruan se i takon institucioneve dhe jo partive politike, që ose jo rezultatin e zgjedhjeve. Pohimi: Në demokraci rregullat janë të qarta dhe të njohura

KOMENT
Blihen skllëvër
Nga Frrok Çupi
A ja skllëvër i ky shekull?... Kjo është çështja. Në kohën e skllëvërimit, skllëvër ishte skllëvër dhe pronari i skllëvërve skllëvëronar, secili në vendin e vet. Kur skllëvërit... >>> **Faqe 5**

ANALIZË
Tadiç, Serbia e Madhe dhe çështja shqiptare
Nga Xhavit Shala
Ditët e fundit, autoritetet më të larta të shtetit dhe politikës serbe, si presidenti Boris Tadiç, njëkohësisht lider i Partisë Demokratike... >>> **Faqe 6**

TE 576 EMRAT

Marko Belushi: PS e humbën Tiranën, Kolegji dha vendim profesional

Deputeti i Partisë Socialiste Marko Belushi, tha dje se përveç Tiranës, PS ka arritur fitore në gjithë vendin

SUMMER TIME